



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 16.04.2019

Ref.: 61/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 68-të, të mbajtur më 10 prill 2019, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht ankesa Nr.520/19H, datë 29.03.2019 e Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca", si e bazuar.
2. Ndryshohet pika I (një) e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.311/19D, datë 22.02.2019.
3. Aprovohet aplikacioni i Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca", për riakreditim të programeve të studimit, Biokimi Laboratorike, BSc, 180 ECTS, dhe Radiologji Diagnostike, BSc, 180 ECTS.
4. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.311/19D, datë 22.02.2019 mbetet e pa ndryshuar.
5. Autorizohet Drejtori i AKA-së për zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme për këto programe të studimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Arsyetimi

KSHC me vendim Nr.311/19D, datë 22.02.2019 ka refuzuar aprovimin e aplikacionit për ri/akreditimin e programeve të studimit si në vijim: Farmaci Komunitare, BSc, 180; Fizioterapi, BSc, 180 ECTS; Infermieri, MSc, 120 ECTS; Stomatologji, Dr. Dent. (Integrated), 300 ECTS, Mjekësi e Përgjithshme, Dr. Med. (Integrated), 360 ECTS; Fizioterapi, MSc, 120 ECTS; Biokimi Laboratorike, MSc, 120 ECTS, dhe Anesteziologji Dhe Kujdes Intensiv, BSc, 180 ECTS.

Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca", brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.311/19D, datë 22.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 29.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të

ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).

Përmes kësaj ankesa, Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca" ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programin e studimit, Biokimi Laboratorike, BSc, 180 ECTS, dhe Radiologji Diagnostike, BSc, 180 ECTS, të cilat kanë qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.311/19D, datë 22.02.2019.


Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë për këtë program të studimit, janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 68-të të KSHC-së, të mbajtur me 10 prill 2019, dhe në fund, KSHC erdhi në përfundim që ankesa është pjesërisht e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programet e studimit, Biokimi Laboratorike, BSc, 180 ECTS, dhe Radiologji Diagnostike, BSc, 180 ECTS, i plotësojnë kushtet për të qenë bartës të programit të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pjesën tjetër të ankesës për programet e studimit: : Farmaci Komunitare, BSc, 180; Fizioterapi, BSc, 180 ECTS; Infermieri, MSc, 120 ECTS; Stomatologji, Dr. Dent. (Integrated), 300 ECTS; Mjekësi e Përgjithshme, Dr. Med. (Integrated), 360 ECTS; Fizioterapi, MSc, 120 ECTS; Biokimi Laboratorike, MSc, 120 ECTS, dhe Anesteziologji Dhe Kujdes Intensiv, BSc, 180 ECTS, KSHC vendosi që këtë çështje ta referoj për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave, bazuar në pikën pesë të nenit 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca";
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

